



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1557 Prot.

Tiranë, më 10.06. 2024

V E N D I M Q A R K U L L U E S

Nr. 46 dt. 10.06. 2024

“PËR
SHLYERJEN E DETYRIMEVE DERI NË SEZONIN E VJESHTËS PËR STUDENTËT E
KURSIT TË TRETË NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE PRANË NJËSIVE
KRYESORE TË UST-SË”

Mbështetur në nenin 3, 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, VKM-në nr. 57, datë 29.1.2020 “Për dhënien e Statusit të Veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, në nenin 7, 20 të Statutit të UST-së, në nenin 7, 95 të Rregullores së UST-së, nenin 8 pika 1, gërma c dhe 11 pika 2 të Rregullores së Provimeve të Universitetit të Sporteve të Tiranës, Urdhërin e Përbashkët të Rektorit dhe Administratorit nr. 9, datë 17.05.2024 “Për shtyrjen e afatit të shlyerjes së detyrimeve financiare”, Vendimin e Rektoratit nr. 48, datë 07.06.2024 “Për shlyerjen e detyrimeve deri në sezonin e vjeshtës për studentët e kursit të tretë në ciklin e parë të studimeve pranë njësive kryesore të UST” Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Mundësimin e mbrojtjes 100% të detyrimeve përpara fillimit të sezonit të vjeshtës, të të gjithë studentëve të kursit të III-të, në ciklin e parë të studimeve (bachelor), në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
2. Ngarkohen njësitë bazë pranë njësive kryesore së bashku me stafin akademik përkatës, që të hartojnë grafikun e shlyerjes së detyrimeve dhe tua bëjnë me dije studentëve.
3. Studentët të cilët plotësojnë detyrimet, do të lejohen që të japin provimet në sezonin e vjeshtës.
4. Ky Vendim t’i përcillet për zbatim Njësive Kryesore të UST dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA

